



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Etablissements J. Soufflet nga shoqëria InVivo Group.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.273 Prot., i AK, datë 31.05.2021 “Transaksion Përqendrimi”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë Etablissements J. Soufflet nga shoqëria InVivo Group

Sipas “Protokoll Shitjeje” të nënshkruar më datë 01 maj 2021, palët janë:

Pala Blerëse: InVivo Group është një shoqëri aksionare e thjeshtuar (shoqëri me një ortak të vetëm), regjistruar sipas legjislacionin francez, me objekt veprimtarie: ofrim shërbimesh për shoqëritë e sektorit bujqësor. InVivo Group zotërohet plotësisht nga Union InVivo.

InVivo group nuk ka filiale në Shqipëri dhe nuk ka realizuar të ardhura në tregun shqiptar në vitin 2020.

Garantuesi: Union InVivo është një bashkim kooperativash bujqësore me kapital të ndryshueshëm (kooperativa sipas ligjit francez), me objekt aktiviteti: ofrim shërbimesh për shoqëritë e sektorit bujqësor.

Pala shitëse:

Shitësi 1: Z. Michel Soufflet, person fizik, shtetas i huaj, i regjistruar në shtetin francez dhe aksionar i shoqërisë Etablissements J. Soufflet, ku zotëron 67.64% të kapitalit të shoqërisë target.

Shitësi 2: Z. Jean-Michel Soufflet, person fizik, shtetas i huaj, i regjistruar në shtetin francez dhe aksionar i shoqërisë Etablissements J. Soufflet, ku zotëron 2.58% të kapitalit të shoqërisë target.

Shitësi 3: Silos Soufflet, shoqëri aksionare e thjeshtuar, e regjistruar sipas legjislacionin francez, me objekt aktiviteti: mbajtjen ose zotërimin e letrave me vlerë të kompanive të tjera, përveç bankave. Silos Soufflet përfaqësohet nga Z. Jean-Michel Soufflet dhe zotëron 17.38% të kapitalit të shoqërisë target.

Shitësi 4: Sceaux International, shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, regjistruar sipas legjislacionit hollandez, përfaqësuar nga Z. Jean-Michel Soufflet dhe zotëron 12.41% të kapitalit të shoqërisë target.

Shoqëria Target: Etablissements J. Soufflet është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas legjislacionin francez, me objekt veprimtarie: shitjen dhe blerjen, importimin dhe shfrytëzimin e farave, drithërave, kashtës, transformimin dhe shitjen e të gjitha produkteve bujqësore dhe të gjitha veprimtaritë e ngjashme apo të lidhura me qendrat e farave etj. Etablissements J. Soufflet është shoqëria holding e Soufflet Group.

Etablissements J. Soufflet nuk ka filiale në Shqipëri, por ka realizuar të ardhura në tregun shqiptar në vitin 2020, nëpërmjet shoqërive që ka në zotërim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.